L I G J
Nr.9597, datë 27.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pika 2.1 e nenit 26 "Importimi i mallrave" të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

"2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në gjashtë muaj. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit.

Këshilli i Ministrave përcakton me udhëzim skemën e shtyrjes së pagesës.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5017, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu